



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 17 Prot.

Tiranë, më datë 15.01.2024

VENDIM
Nr. 15, datë 15.01.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 15.01.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “*Godinë Polifunkionale*” me vendndodhje në Zonën Kadastrale 8150, me nr. pasurie 1/238, 1/66, 1/62, 1/547, 1/197, 1/220, 1/251, 1/252”, Bashkia Tiranë, hartuar nga subjekt i licencuar në arkeologji z. Taulant Rama, me aplikues dhe **zhvillues FUSHA shpk**;
 2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “*Godinë Polifunkionale 2-33 kate, me 4 kate parkim nëtokë*”, me vendndodhje në Zonën Kadastrale 8150, me nr. pasurie 1/238, 1/66, 1/62, 1/547, 1/197, 1/220, 1/251, 1/252”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
 3. Subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, me kushtin që projekti i zbatimit në vijim të reflektojë informacione shtesë përshkrimore dhe grafike mbi impaktin që ky objekt do të ketë me zonën, strukturat dhe monumentet përreth;
 4. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, datë 17.05.2018, neni 72, pika 1 dhe 2;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
 7. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

